



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË DOKUMENTACIONIT
BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 2138/16 Prot

Tiranë, më 24.09.2019

RELACION

MBI VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Drejtuar: Znj. ARTA MARKU, PROKURORE E PËRGJITHSHME

Nga: SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

E nderuar zonja Marku,

Pasi u njohëm me Vendimin nr. 161, datë 02.08.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për mbarimin e mandatit si anëtar i KLP të z. Gentjan Osmani”, konstatojmë se:

Me vendimin e Kolegjit të Posaçëm i Apelit, nr. 20, datë 31.07.2019, është vendosur: Ndryshimi i Vendimit nr. 61. Datë 02.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit Gentjan Osmani.

Z. Gentjan Osmani ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i zgjedhur nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë të Shkallëve të Para. Me mbarimin e mandatit të një anëtari të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bazuar në nenin 149/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më datë 02.09.2019 Prokurori i Përgjithshëm ka shpallur Thirrjen për Paraqitjen e Shprehjes së Interesit për kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Brenda afatit ligjor, rezultojnë të janë depozituar **2 (dy)** kërkesa, nga prokurorët për të kandiduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

1. **Z. Vladimir Mara**, me detyrë prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda, paraqiti kërkesën nr. 2138/2 prot. datë 16.09.2019.
2. **Znj Esmeralda Keshi (Cami)**, me detyrë prokurore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Dibër, paraqiti kërkesën nr. 2138/3 Prot. datë 16.09.2019.

- **Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të**

Prokurorisë, parashikuar nga neni 105 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, janë:

- a) në kohën e kandidimit, të kenë ushtruar funksionin e prokurorit për të paktën 10 vjet;
- b) në kohën e kandidimit, nuk duhet të jenë drejtues të një zyre prokurorie ose anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata prokurorësh, sindikata prokurorësh etj. ;
- c) të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale;
- ç) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- e) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- ë) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

- Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për shprehje interesi, në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”:

- a) jetëshkrimi i përditësuar;
- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;
- c) formulari i vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungi/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor;
- ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Në mbështetje të nenit 109, pika 1 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Sektori i Burimeve Njerëzore, ka kryer verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe në përfundim

KONSTATOI:

➤ **I. Kandidati Vladimir Mara**, prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda:

- a) *Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej 11 vjetësh (bashkëlidhur Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5846, datë 29.07.2008);*
- b) *Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit (verifikuar dosja personale);*
- c) *Është vlerësuar “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016).*
- ç) *Nuk ka masa disiplinore në fuqi (vlerësuar sipas dosjes personale);*
- d) *Nuk është i dënuar më parë (bashkëlidhur çertifikata elektronike nr. 1105, datë 20.09.2019);*
- dh) *Nuk është bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 463/12, datë 03.04.2019. i AISSH);*
- e) *Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (sipas shkresës nr. 3952/14 prot., datë 24.09.2019 të SHISH);*
- ë) *Në kohën e kandidimit, nuk ka asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar (bashkëlidhur Formulari i Dhënies së Informacionit datë 12.09.2019).*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar të gjitha dokumentet në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Përsa më sipër dhe pas konfirmimit në detyrën e magjistratit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me Vendimin nr.158 datë, 14.06.2019, Sektori i Burimeve Njerëzore, arrin në përfundimin se z. **Vladimir Mara**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, plotëson kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

➤ **II. Kandidati Esmeralda KESHI (Cami)**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër:

- a) *Ka ushtruar funksionin e prokurorit prej rreth 11 vjetësh (bashkëlidhur Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5925, datë 06.11.2008);*
- b) *Në kohën e kandidimit nuk ushtron funksionin e drejtuesit (bashkëlidhur kërkesa e miratuar e dorëheqjes drejtuar KLP - së);*
- c) *Është vlerësuar “shumë mire” në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale; (vlerësimet e punës për vitin 2015 dhe vitin 2016).*
- ç) *Nuk ka masa disiplinore në fuqi (vlerësuar sipas dosjes personale);*
- d) *Nuk është i dënuar më parë (bashkëlidhur çertifikata elektronike nr. 1105, datë 20.09.2019);*
- dh) *Nuk është subjekt në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (bashkëlidhur deklarata e kandidatit, si dhe Vendimi nr. 592, datë 23.09.2019. i AISSH);*
- e) *Nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete (sipas shkresës nr. 3952/14 prot., datë 24.09.2019 të SHISH);*
- ë) *Në kohën e kandidimit, nuk ka asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar (bashkëlidhur Formulari i Dhënies së Informacionit datë 12.09.2019).*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, që i është bashkëlidhur kërkesës për shprehje interesi, u konstatua se janë dorëzuar të gjitha dokumentet në përputhje me nenin 108 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Përsa më sipër dhe pas konfirmimit në detyrën e magjistratit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me **Vendimin nr.163, datë 19.06.2019**, Sektori i Burimeve Njerëzore, arrin në përfundimin se znj. **Esmeralda Keshi (Cami)**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, plotëson kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore

Enkeleida ZOTKAJ